

## **Konkluzionet e Përbashkëta të takimit të 6-të të Dialogut të Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyce**

**Tiranë, 30 Mars 2016**

- 1) Kryeministri Edi Rama dhe Komisioneri Johannes Hahn kryesuan takimin e gjashtë të Bashkë-Bisedimeve të Nivelit të Lartë (HDL) mbi prioritetet kyce ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit European në 30 Mars 2016. Morën pjesë në seancën (sesionin) plenar Ministrat e Qeverisë, gjithashtu edhe anëtarë nga opozita.
- 2) Komisioneri Hahn vlerësoi progresin e qëndrueshëm nga ana e Shqipërisë në fushën e politikave që mbulohen nga pesë prioritetet kyce për hapjen e negociatave.
- 3) Komisioneri e mirëpriti dhe e përgëzoi zbatimin e vazhdueshëm të Ligjit Për Nënpunësin Civil dhe ftoi Shqipërinë që të përmirësojë akoma më shumë procedurat e rekrutimit të kësaj kategorie. Gjithashtu, mirëpriti dhe vlerësoi përgatitjen e vendit tonë për hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurave Administrative dhe bëri thirrje për forcim të mëtijshëm të masave përgatitore.
- 4) Më tej, ai mirëpriti dhe progresin për reformën në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë këtu punën e bërë nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, draftin mbi ndryshimet kushtetuese mbi riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, dhe gjithashtu përfshirjen e Komisionit të Venecias në këtë proces. Komisioneri inkurajoi autoritetet që të arrijnë një marrëveshje në të njëjtën linjë me opinionin e Komisionit të Venecias dhe vuri theksin mbi rëndësinë e plotësimit të një procesi reformues në drejtësi gjithëpërfshirës, të kuptueshëm dhe të qëndrueshëm, gjë e cila është e thelbësore dhe e domosdoshme për të rritur besimin e publikut në sistemin gjyqësor si edhe për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Komisioneri nënvizoi se reforma në sistemin e drejtësisë është një hap përpara për Shqipërinë në procesin e pranimit në BE. Ai bëri thirrje për të gjithë, që të punojnë për kompromiset e nevojshme dhe që të jenë në vijimësi dhe në të njëjtën linjë pune me standartet Europiane, duke treguar të gjithë mbështetjen e plotë në këtë reformë thelbësore. Ai vuri theksin midis të tjerash, në zbatimin e kësaj reforme.
- 5) Komisioneri Hahn inkurajoi Shqipërinë që të tregojë më shumë progres në ndërtimin e një historiku të regjistrimit të hetimeve, ndjekjeve dhe denimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet, dhe të sigurojë një ndjekje korrekte të numrit të lartë të çështjeve referuar Prokurorise nga Inspektoriati I Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit (ILDKPKI). Komisioneri mirëpriti rezultatet konkrete të arritura në luftën kundër kultivimit të narkotikëve dhe trafikut të drogës, dhe nënvizoi se bashkëpunimi midis agjensive ligj-zbatuese ka nevojë të forcohet në mënyrë që të cmontojë në mënyrë efektive rrjetet kriminale.
- 6) Sa i përket zbatimit dhe përforcimit të të drejtave të njeriut, Komisioneri inkurajoi Shqipërinë të rrisë përpjekjet për gjithëpërfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve, duke

përfshirë këtu zbatimin efektiv të Planit të Veprimit Kombëtar për Integrimin e komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve, dhe për të zhvilluar politika udhërrëfyese për rastet e dëbimit që janë në të njëjtën linjë me standartet ndërkombëtare. Komisioneri inkurajoi Shqipërinë që të sigurojë zbatimin e të drejtës së pronës dhe të bëjë progres të mëtijshëm në procesin e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pasurive të paluajtshme. Komisioneri theksoi rëndësinë e ndërtimit të një sistemi të ri gjyqësor në bashkërendim me standartet ndërkombëtare dhe praktikën e mira. Ai e mirëpriti faktin që kjo reformë është trajtuar në kuadër të reformës së përgjithshme në drejtësi .

- 7) Së fundi , Komisioneri mirëpriti ngritjen e Këshillit Kombëtar për Integrimin European (KKIE) dhe inkurajoi të gjithë anëtarët që të vazhdojnë të investojnë në të, në mënyrë që ky komision të kthehet në një instrument real për të promovuar bashkë-bisedimet për integrim në Bashkimin European.
- 8) Kryeministri Edi Rama konfirmoi se angazhimi i qeverisë së tij për të forcuar më tej progresin e arritur në reformat e lidhura me BE-në, në vecanti për të vazhduar zbatimin e reformave në fushën e shtetit të së drejtës, duke përfshirë dhe politikën anti-korrupsion, reformën në gjyqësor, dhe luftën kundër krimit të organizuar është dhe do të jetë i konsiderueshëm dhe maksimal. Kryeministri Edi Rama nënvizoi se adoptimi i legjislacionit kyç për kuptueshmërinë e reformës në drejtësi është instrumental drejt hapave të tjerë të Shqipërisë në procesin e pranimit në BE dhe se do të përgatisë terrenin për më shumë punë që do të ndërmerret në kuadër të negociatave të kapitujve 23 dhe 24 dhe se gjithashtu do të ketë një efekt transformues në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ai konfirmoi angazhim të fortë të qeverisë shqiptare në zbatimin e legjislacionit për reformën në drejtësi, në kuadër të negociatave të kapitujve 23 dhe 24. Autoritetet shqiptare parashikuan përditësimin e veprimeve të planifikuara për trajtimin e mëtijshëm të pesë prioritetëve kyçe.
- 9) Qeveria shqiptare konfirmoi përfshirjen dhe angazhimin e saj në një dialog konstruktiv dhe të qëndrueshëm me opozitën, i cili shihet si domosdoshmëri dhe vitale për qëndrueshmërinë e procesit të reformës.
- 10) U ra dakord që Shqipëria do të raportojë rregullisht mbi zbatimin e pesë prioritetëve kyçe për të hapur negociatat e pranimit.
- 11) Komisioni do të vazhdojë të sigurojë dhe japë mbështetje për Shqipërinë për përmbushjen e kërkesave për hapjen e negociatave të pranimit.